

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT PËR PROVIMET

Kushtet e përgjithshme të pjesëmarrjes

Pjesëmarrësi në provim duhet të jetë të paktën 12 vjeç dhe duhet të paraqesë një pasaportë të vlefshme në momentin e fillimit të provimit. Pjesëmarrësit në provim janë të detyruar të njohin rregulloren e provimit. Duke u regjistruar për provim dhe duke paguar tarifën e provimit, personi që do të marrë pjesë në provim konfirmon se është njohur me rregulloren aktuale dhe udhëzimet për zbatim të provimit dhe i pranon ato. Rregullorja dhe udhëzimet për zbatim e provimit gjenden në përshkrimin e provimit përkatës. .

1. Regjistrimi për provim dhe kushtet e pagesës

- 1.1.** Pjesë e marrëveshjes janë tarifat e vlefshme në momentin e regjistrimit në provim, të cilat janë afishuar në faqen e internetit të Goethe-Zentrum.
- 1.2.** Në rast se pagesa e plotë e tarifës së provimit nuk bëhet në kohë, kandidati humbet të drejtën për të marrë pjesë në provim. Tarifa e provimit mund të shlyhet me kartë krediti/debiti në zyrën e regjistrimit, ose me transfertë bankare.
- 1.3.** Pjesëmarrës të cilët në çastin e regjistrimit në një provim të Goethe-Institut janë të regjistruar edhe në një kurs aktual pranë qendrës sonë, përfitojnë zbritje në tarifën e provimit. Kjo vlen vetëm për provimet e Goethe-Institut dhe jo për provimet TestDaF dhe TestAS.
- 1.4.** Regjistrimi për provim mund të bëhet deri në 1 javë para datës së provimit. Numri i vendeve për provim është i kufizuar dhe regjistrimet mund të bëhen vetëm nëse ka vende të lira.
- 1.5.** Regjistrimi është i përfunduar vetëm kur [formulari i regjistrimit](#) është plotësuar dhe është paguar e gjithë shuma e tarifës së provimit. Konfirmimi për datën e provimit do të konfirmohet me një email zyrtar nga Goethe-Zentrum.

2. Tërheqja dhe shtyrja e datës së provimit

- 2.1.** Në rast se personi që do të marrë pjesë në provim nuk mund të marrë pjesë në provimin për të cilin është regjistruar ose dëshiron të shtyjë datën e provimit, vlejné kushtet e mëposhtme të çregjistrimit:

2.1.1. Tërheqja nga provimi ose shtyrja e datës për një datë provimi tjetër është e mundur deri në 5 ditë pune para datës së provimit pa qenë e nevojshme për të dhënë arsye. Tarifa e provimit do të kthehet e tërëa.

2.1.2. Nëse tërheqja ose kërkesa për shtyrje provimi ndodh më vonë, atëherë kjo miratohet vetëm me paraqitjen e një raporti mjekësor.

2.1.3. Për TestAS dhe TestDaF, zbatohen kushtet e tërheqjes të institucionit përkatës (www.testdaf.de dhe www.testas.de).

2.1.4. Njoftimi për çregjistrimin duhet paraqitur me shkrim. Si datë njoftimi vlen data e mbërritjes së njoftimit në Goethe-Zentrum.

2.1.5. Të gjitha kostot (të transferimit) bankar mbulohen nga personat që regjistrohen në provim.

3. Dëshmitë e pjesëmarrjes dhe certifikatat

3.1. Dëshmia e pjesëmarrjes në provim ose pjesët e provimit të cilat nuk janë kaluar mund të lëshohen pa pagesë nga Goethe-Zentrum sipas kërkesës.

3.2. Dëshmitë e pjesëmarrjes dhe certifikatat ruhen në Goethe-Zentrum deri në 10 vjet. Koha maksimale e ruajtjes së dokumentacionit të provimeve është përcaktuar në Rregulloren e Provimeve të Goethe-Institut.

3.3. Lëshimi i një dublikate bëhet vetëm me pagesë: 2.000 lekë për certifikatat e Goethe-Institut. Pas përfundimit të afatit maksimal për ruajtjen e dokumentacionit, lëshimi i një dublikate është i pamundur.

4. Pjesëmarrësit me nevoja të veçanta fizike

4.1. Instituti Goethe dhe partnerët e bashkëpunimit në provime janë të angazhuar të përshtaten në mënyrë individuale me nevojat e veçanta të kandidatëve me nevoja të veçanta fizike. Modifikimet janë të mundshme vetëm nëse ekziston një raport mjekësor në anglisht ose gjermanisht për nevojat e veçanta dhe kjo paraqitet bashkë me regjistrimin [Udhëzimet e Zbatimit për Pjesëmarrësit me Nevoja të Veçanta](#) . Modifikimet në zbatimin e provimit janë të mundshme aktualisht për:

4.1.1 Kandidatët me probleme të shikimit ose të verbër

4.1.2 Kandidatët me probleme të dëgjimit ose të shurdhër.

4.1.3 Kandidatët me kufizime motorike të qëndrueshme dhe të përkohshme (si për shembull dorë e thyer për shkrim).

4.1.4 Kandidatët me vështirësi në lexim dhe/ose shkrim (legastheni ose disleksi).

4.1.5 Kandidatët me çrregullime të vëmendjes dhe aktivitetit (ADS/ADHS).

4.1.6 Kandidatët me vështirësi në të folur (si për shembull, belbëzim).

5. Detyrimet

Pjesëmarrësi në provim ka për detyrë të zbatojë kushtet e përgjithshme të biznesit të Goethe-Zentrum dhe rregulloren e provimeve.

6. Përgjegjësia e Goethe-Zentrum / forcat madhore

Goethe-Zentrum nuk mban përgjegjësi për dëme të shkaktuara nga pjesëmarrësit në provim nga veprime të qëllimshme apo nga pakujdesia. Goethe-Zentrum nuk mban përgjegjësi për mosfrimin e shërbimeve të saja të ndikuara nga forcat madhore (p.sh. në rast katastrofash natyrore, zjarri, përmbytjesh, lufte, urdhri nga institucionet shtetërore dhe në të gjitha rrethanat e tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të palëve në marrëveshje). Goethe-Zentrum nuk mban përgjegjësi për sendet personale dhe me vlerë të kursantëve dhe të pjesëmarrësve të provimit.

7. Mbrojtja e të dhënave

Për qëllime të verifikimit të vertetësisë dhe për dhënien e certifikatave zëvendësuese, të dhënat lidhur me provimet mund të përcillen në Goethe-Institut dhe të ruhen ose përdoren në arkivin qendror të provimeve (maksimumi 10 vjet). Përveç kësaj, të gjitha të dhënat mund të transmetohen te autoritetet shqiptare dhe gjermane për qëllime të verifikimit të vertetësisë në rast nevoje.

Aktualizimi i fundit: 13.09.2023



PRÜFUNGSZENTRUM
GOETHE-INSTITUT

GOETHE-ZENTRUM
KOOPERATIONSPARTNER



GOETHE
INSTITUT